



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7/2023 (JR)
Nr. 7/2. regj.

Tiranë, më 13.05.2025

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e **hënë, në datën 30.06.2025, ora 09:30**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 7/2023 (JR), datë 14.02.2023, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 605, datë 21.12.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjykues
Relator i Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare**

**Rezarta Schuetz
Sokol Çomo
Natasha Mulaj
Ina Rama
Mimoza Tasi**

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe në të dhënat elektronike të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

REZARTA SCHUETZ

